

Fehari Ramadani  
Hiriet Ziberi

## POLITIKA BALLKANIKE E AUSTRO-HUNGARISË DHE PAVARËSIA SHQIPTARE

### АВСТРОУНГАРСКАТА БАЛКАНСКА ПОЛИТИКА И АЛБАНСКАТА НЕЗАВИСНОСТ

### AUSTRO-HUNGARIAN BALKAN POLICY AND ALBANIAN INDEPENDENCE

Që nga vitet 60 të shek. XIX, fillon interesimi i qeverisë habsburge për Ballkanin osman në përgjithësi dhe çështjen shqiptare në veçanti. Pasi humbi rolin udhëheqës në botën gjermane, për të ruajtur autoritetin e Fuqisë së Madhe, Austrisë i duhej që të gjente një territor ku ta shtrinte ndikimin e saj. Kjo e detyroi këtë perandori t'i kthente sytë drejt pjesës evropiane të Perandorisë Osmane. Disfata që ajo pësoi në Sadova, në luftën kundër Prusisë në vitin 1866<sup>1</sup> dhe Paqja e Pragës, e 23 gushtit të atij viti, detyroi qeverinë e Vjenës të tërhiqej nga Gjermania, duke i lënë dorë të lirë kancelarit prusian, Bismarkut, t'i rregullonte sipas planeve të tij problemet gjermane<sup>2</sup>. Konfederata Gjermane u shpërnda dhe që atëherë, Perandoria Habsburge\* përfundimisht hoqi

---

<sup>1</sup> Krasniqi, Rexhep. 2007. *Kongresi i Berlinit e Verilindja e Shqipnisë*. Tiranë: Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Arbnori", f. 41.

<sup>2</sup> Krahaso: Nathanaili, Petrit. 2006. *Marrëdhëniet Ndërkombëtare nga origjina deri më sot, vëllimi i parë*. Tiranë: ShBLU, f. 329, 340; Gurakuqi, Romeo. 2004. *Historia e Kohës së Re (2) Qytetërimi Perëndimor 1775-1871*. Shkodër: PHOENIXSHKODRA, f. 399-402;

*Енциклопедија на Југославија, издание на Македонски јазик*. 1983. Загреб: Jugoslovenski Leksikografski Zavod, s. 20; Тејлор, Алан Џ. П. 2001. *Хабсбуршка Монархија 1809-1918. Историја Аустријске Царевине и Аустроунгарске*. Београд: Clío, s. 143-144; Rich, Norman. 2006. *Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1814-1914*. Tiranë: Toena, f. 205.

\* Me **Kompromisin** (*Ausgleich*) e arritur në vitin 1867, midis Vjenës dhe Budapestit, Monarkia Austriake u shndërrua në shtet të dyfishtë (dualist), i cili do të quhet Perandoria **Austro-Hungareze**. Ajo tanimë do të përbëhej nga dy shtete (entitete) të pavarura dhe të barabarta, me një sundimtar të përbashkët, i cili do të quhej perandor në Austri dhe mbret në Hungari. Do të kishin një ushtri të përbashkët dhe tri Ministri të përbashkëta: atë të Punëve të Jashtme, të Luftës (Mbrotjtjes) dhe të Financave. Për të mbikëqyrur punën e dikastereve të përbashkëta ministrore,

dorë nga procesi i bashkimit të Gjermanisë. Rreth 10 milionë austriakë gjermanishtfolës mbetën jashtë “*bashkësisë gjermane*”. Mirëpo, megjithëse Austria u mund, ajo përsëri mbeti një Fuqi e Madhe, ndonëse jo si më parë.

Humbja e ndikimit në Gjermani, e shtyu Vjenën që të kërkonte territore të reja ku ajo do të mund ta shtrinte ndikimin e saj dhe të vazhonte ta ruante statusin e Fuqisë së Madhe. I vetmi territor që i mundësonte qeverisë habsburge realizimin e këtij objekti ishte Ballkani osman. Kjo për dy arsye. E para se Austro-Hungaria, përpos se në pjesën jugore, në të gjitha anët kufizohej me Fuqi të Mëdha (Perandorinë Ruse, Perandorinë Gjermane, Mbretërinë e Italisë) ose me shtetin neutral, Zvicrën çka i pamundësonte asaj ta përhapte ndikimin e saj në ato territore. E dyta se dobësimi i vazhdueshëm që kishte përfshirë Perandorinë Osmane në fund të shek. XIX, e bënte të afërt ditën kur pushteti i sulltanit do të largohej përfundimisht nga kjo pjesë e Evropës Juglindore. Prandaj, që nga fundi i shek. XIX, qeveria e Vjenës i kushtoi rëndësi gjithnjë e më të madhe fuqizimit të autoritetit të saj sidomos në Ballkanin Perëndimor, të banuar nga popullsia shqiptare. Austro-Hungaria ishte e interesuar të kishte dalje të sigurt në detin Mesdhe nëpërmjet Adriatikut dhe këtë mund ta siguronte vetëm duke siguruar simpatinë e shqiptarëve. Për këtë arsye Austro-Hungaria u angazhua seriozisht të ndihmonte shqiptarët në forcimin e vetëdijes kombëtare, me qëllim që kur Stambolli të humbte pushtetin në Ballkan, shqiptarët me ndihmën e Vjenës të formonin shtetin e tyre, i cili do të ishte i lidhur me habsburgët.

---

të dy parlamentet kombëtare zgjidhnin komitetet (delegacionet) e tyre, të cilat do të takoheshin në Vjenë ose Budapest në sesione të përbashkëta ose të komunikimit nëpërmjet korrespondencës. Këshilli i Kurorës vepronte si kabinet i përbashkët. Ai përbëhej prej kryeministrave, ministrave, arqidukëve dhe Shefit të Gjeneralshtabit. Ky organ kishte për detyrë t'i jepte këshilla perandorit, megjithëse vendimet e **rëndësishme politike**, mbeteshin kompetencë e perandorit. Të gjitha institucionet tjera do të ishin të veçanta. Këto dy pjesë nuk kishin të përbashkët as Kryeministrin me qeverinë, secila kishte kryeministrin dhe qeverinë e vetë, parlamentin e veçantë, shërbim të veçantë civil dhe sistem administrativ. Si kufi ndaras midis këtyre dy njësive do të shërbente lumi Leitha. Kompromisi solli një krijesë konstitucionale krejt të pangjashme. Të dy shtetet e pavarura nuk ishin tërësisht sovraane, siç ndodh në rastet e konfederatës. Mirëpo, në këtë rast nuk kemi të bëjmë as me kontrollin e një shteti mbi dy njësitë shtetërore, siç ndodh në rastin e një federate. Të dy njësitë ndajnë një sundimtar të përbashkët dhe kishin edhe institucione tjera të përbashkëta. Ideja bazë që qëndronte prapa Kompromisit ishte njësimi i dy shteteve në një bashkim mbretëror. (Ramadani, Fehari. 2010. Vështrim i shkurtër i krijimit dhe zhvillimit të Perandorisë Austro-Hungareze. Në *Kërkime Historike*, Nr. 4. Shkup: SHHSHM, f. 125-126).

Austro-Hungaria duke qenë në rivalitet me Perandorinë Ruse (më vonë edhe me Italinë), për dominim në Ballkan, e kishte të domosdoshme të mbështeste shqiptarët dhe Lëvizjen e tyre kombëtare, pasi të gjithë popujt tjerë të Ballkanit, në fillim të shek. XX, ishin futur në sferën ruse të ndikimit. Me përjashtim të shqiptarëve, popujt tjerë ishin të lidhur në një formë ose një tjetër me rusët. Serbët, malazezët, bullgarët\* për shkak të origjinës sllave dhe grekët për shkak të fesë ortodokse më të afërt ishin me Rusinë se sa me Austro-Hungarinë. Në anën tjetër shqiptarët e ndjenin veten të rrezikuar nga politika ballkanike e Rusisë, pasi kjo e fundit duke përkrahur popujt tjerë, rrezikonte copëtimin e territoreve shqiptare. Kështu, nga fundi i shek. XIX dhe gjatë dy dhjetëvjeçarëve të parë të shek. XX, një aleancë e shqiptarëve me Austro-Hungarinë ishte e natyrshme.

Gjatë vitit 1912, shqiptarët organizuan dhe zhvilluan Kryengritjen e përgjithshme. Luftimet midis kryengritësve dhe forcave qeveritare vazhduan për disa muaj derisa shqiptarët arritën ta çlironin Shkupin, kryeqendrën e Vilajetit të Kosovës, më 12 gusht 1912. Në qendër të bisedimeve, që Hasan Prishtina, udhëheqësi kryesor i kryengritjes, zhvillonte me përfaqësuesit e qeverisë osmane për ndërprerjen e saj, qëndronte kërkesa për autonominë e Shqipërisë. Pas shumë hezitimesh, më në fund, më 18 gusht, Porta e Lartë shpalli se kishte pranuar memorandumin e Hasan Prishtinës, ndonëse me disa ndryshime jo pa rëndësi. Megjithëse, kryengritja e përgjithshme përfundoi pa arritur objektivat e caktuara, ajo përgatiti terrenin për shpalljen e pavarësisë<sup>3</sup>.

Më 13 gusht, menjëherë pasi kryengritësit kishin çliruar Shkupin\*, ministri i Jashtëm i Austro-Hungarisë, konti Berchtold\*, i quajti të arsyeshme 14 kërkesat e shqiptarëve, të përmbledhur në memorandumin e Hasan Prishtinës dhe bëri përpjekje që ato të përkraheshin edhe nga Fuqitë tjera të Mëdha. Berchtold u propozoi Fuqive të Mëdha që të ndërmerrnin një hap kolektiv në Stamboll për të kërkuar zbatimin e politikës së decentralizimit, e cila do t'i përshtatej gjendjes etnike reale

\* Megjithëse bullgarët realisht nuk konsiderohen si popull me prejardhje sllave, por për shkak se gjuha e tyre bën pjesë në familjen e gjuhëve sllave Rusia i përfshiu brenda lëvizjes pansllaviste dhe mbështeti në vazhdimësi kërkesat e tyre.

<sup>3</sup> *Historia e popullit shqiptar, vëllimi II, vitet 30 të shek. XIX-1912*. 2002. Tiranë: Toena, f. 491-492, 494-496.

\* Më pas kryengritësit shqiptarë, çliruan Kumanovën, Preshevën, Tetovën etj.

\* Konti Leopold von Berchtold (1863-1942), ministër i Punëve të Jashtme i Austro-Hungarisë, në periudhën 17 shkurt 1912-13 janar 1915. Në vitet 1906-1911 kishte shërbyer ambasador në Perandorinë Ruse.

në Perandorinë Osmane. Ai kërkoi gjithashtu që të këshilloheshin qeveritë ballkanike nga Fuqitë e Mëdha për të mbajtur një qëndrim paqësor. Kjo ndërmarrje diplomatike e Vjenës kishte për qëllim të detyronte Stambollin të pranonte kërkesat shqiptare dhe të parandalonte ndërhyrjen e shteteve ballkanike. Por, propozimi i Vjenës nuk gjeti mbështetje te partnerët e saj evropianë. Kundër propozimit të Berchtoldit u shprehën edhe monarkitë ballkanike, të cilat u deklaruan se zbatimi i politikës së decentralizimit do të çonte në krijimin e Shqipërisë autonome dhe se ato “*shqetësoheshin*” në këtë rast për fatin e bashkatdhetarëve të tyre në Perandori<sup>4</sup>. Qeveria osmane, nga ana tjetër, e konsideronte propozimin e ministrit të Jashtëm austro-hungarez si ndërhyrje të huaj në punët e brendshme të shtetit osman<sup>5</sup>. Prandaj, edhe ajo doli kundër këtij propozimi.

Ndonëse propozimi i Berchtoldit (13 gusht 1912) nuk gjeti mbështetje, qeveria e Vjenës vazhdoi interesimin e saj për çështjen shqiptare. Austro-Hungaria ishte e vendosur të mos lejonte që bregdeti lindor i Adriatikut të binte në duart e Italisë<sup>6</sup>, apo të shteteve ballkanike. Fillimi i Luftës Ballkanike, rriti shqetësimet në Ballhausplatz<sup>7</sup>, në lidhje me të ardhmen e Shqipërisë. Sipas një protokolli mbi një konferencë të

<sup>4</sup> Krah.: *Historia e popullit shqiptar...*, 2002, f. 493; Abdyli, Ramiz. 2004. *Lëvizja kombëtare shqiptare 1911-1912*, Libri 2. Prishtinë: Instituti i Historisë, f. 379-380; Skendi, Stavro. 1958. *Mendimi politik dhe veprimtaria kryengritëse shqiptare 1881-1912-* (Përkthyer prej Sejfi Protopapës). New York, f. 31-32; Murzaku, Thoma. 1987. *Politika e Serbisë kundrejt Shqipërisë gjatë Luftës Ballkanike 1912-1913*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë-Instituti i Historisë, f. 89; Prela, Zef. 1962. Problemi shqiptar dhe politika austro-hungareze (1897-1912). Në *Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, (Përmbledhje studimesh kushtuar 50 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë). Tiranë, f. 182; Puto, Arben. 1978. *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914*. Tiranë: 8 Nëntori, f. 99-100; Mehmeti, Drita. 1987. Politika e Fuqive të Mëdha imperialiste ndaj kryengritjeve çlirimtare shqiptare të viteve 1910-1912. Në *Studime Historike*, Nr. 3. Tiranë, f. 172-173; Mousset, Albert. 2004. *Shqipëria përballë Europës (1912-1929)*. Tiranë: Dituria, f. 11; *Haus Hof und Archives, Politiches Archives*, Wien, Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë, Fondi: Dokumente të sjella nga Arkivi Shtetëror në Vjenë dhe të përkthyer në gjuhë gjuhën shqipe, Vj. 22-14-1435. (Më tej: *AIH*, Vj...). Telegram i shifruar, nr. 160, i kontit Szögyény për Vjenën. Berlin, 16 gusht 1912; *AIH*, Vj. 22-22-2260. Dokument nr. 3744. Vjenë 29 gusht 1912; *AIH*, Vj. 22-14-1449. Njoftim për ambasadorin austro-hungarezë në Petërburg, Berlin, Londër, Romë dhe Paris. Vjenë 29 gusht 1912; Métais, Serge. 2006. *Histori e shqiptarëve- nga ilirët deri te Pavarësia e Kosovës*. Tiranë, f. 270; Nika, Nevila. 2003. *Përmbledhje dokumentesh mbi kryengritjet shqiptare (1910-1912)*. Prishtinë: Instituti i Historisë, f. 322; Rappaport, Alfred. 1928. *Rrjedhja e punëve në Shqipëri*, (përkthyer prej Karl Gurakuqit). Tiranë: Mbrothësia, f. 20.

<sup>5</sup> *AIH*, Vj. 22-14-1446. Telegram konfidencial, nr. 72 A-H, i Pallavicinit për ministrin e Jashtëm. Jenikoj, më 25 gusht 1912.

<sup>6</sup> *AIH*, Vj 22-22-2268. Përshkrim i një interviste me kancelarin gjerman, von Bethman Hollweg në Buchlau. Vjenë, më 7 e 8 shtator 1912.

<sup>7</sup> Kadri, H. K. 1331 (sipas kalendarit musliman), 1912. *Türkiye'nin çöküşü*. İstanbul, f. 310.

mbajtur nga fundi i tetorit 1912, në Ministrinë e Jashtme në Vjenë, ishte arritur në konstatimin se Austro-Hungaria kishte “*interesa vitale*”, që të mos lejonte vendosjen e një shteti të madh apo të vogël në brigjet lindore të Adriatikut dhe të detit Jon. Për të penguar pushtimin e bregdetit shqiptar, përveç mjeteve diplomatike, u shqyrtua edhe mundësia e një ndërhyrje ushtarake. Sipas pjesëmarrësve të konferencës, duke pasur parasysh gjendjen e re që ishte krijuar në Ballkan, pas sulmit aleat mbi Perandorinë Osmane, quhej “*e dëshirueshme*” që Shqipëria të bëhej “*autonome apo krejt më vete pasi të zhdukej sovraniteti*” osman. Në lidhje me territorin që do përfshinte shteti i ri, sipas pjesëmarrësve të konferencës, do të ishte në interesin e Monarkisë që “*sa të jetë e mundur të përmbledh në gjë të vet të gjithë shqiptarët që banojnë në tokat turke të Evropës dhe të ketë kufi të natyrshme*”. Do të ishte në interes të Austro-Hungarisë, që ky shtet të shtrihej sa “*të jetë e mundur në anën lindore*”, megjithëse ishin të vetëdijshëm se kjo ishte e vështirë të realizohej, duke pasur parasysh pushtimet që kishin kryer Aleatët Ballkanikë dhe mbështetjen që ata gëzonin te disa Fuqi të Mëdha. Duke marrë parasysh situatën e krijuar u konstatua se për të krijuar një “*Shqipëri e cila mund të jetojë*”, ishte e nevojshme që brenda saj të përfshiheshin territoret deri në lumin Kallama. Greqisë do t’i jepeshin territoret në jug të atij lumi dhe e shumta edhe Janina me rrethinën e saj. Shqipërisë do t’i jepeshin edhe territoret perëndimore të vilajetit të Manastirit, Korça deri në vargmalet në lindje të atij qyteti, qyteti i Manastirit dhe territoret midis liqenit të Ohrit dhe të Prespës, si dhe pjesa më e madhe e prefekturës së Dibrës. Nga territoret e Vilajetit të Kosovës, duhej të përfshiheshin në Shqipërinë autonome, të paktën “*territoret thjeshtë shqiptare të prefekturës së Prizrenit dhe të Pejës*”, kurse sa i përkiste Vilajetit “*thjesht shqiptar të Shkodrës*”, duhej të pengoheshin sa të ishte e mundur synimet pushtuese të Malit të Zi. Pra, Malësia, qyteti i Shkodrës dhe fusha e saj duhej t’i mbeteshin Shqipërisë. Zgjidhja më e mirë do të ishte Shqipëria autonome nën një “*mbrojtje ndërkombëtare*”, pasi kjo do të neutralizonte synimet e fqinjëve. Parapëlqehej që Fuqitë mbrojtëse të kishin kompetenca vetëm në sigurimin e integritetit, por të mos përziheshin në punët e brendshme<sup>8</sup> të Shqipërisë.

Deri në fillim të Luftës së Parë Ballkanike, Austro-Hungaria mbante një qëndrim të rezervuar ndaj kryengritjeve shqiptare, duke iu përmbajtur politikës së saj të ruajtjes së *status quo*-së në Ballkan, por

<sup>8</sup> AIH, Vj. 22-23-2312. Protokoll nr. 4170 mbi një konferencë të mbajtur në Ministrinë e Jashtme në Vjenë, pa datë (Konferenca është mbajtur midis 25 e 30 tetorit 1912).

fillimi i Luftës nxori në shesh mundësinë e copëtimit të trojeve shqiptare<sup>9</sup>, çka e nxiti qeverinë e Vjenës të mbështeste krijimin e një shteti autonom shqiptar.

Me gjithë kundërshtimin e Vjenës dhe të Fuqive të tjera të Mëdha, më 8 tetor të vitit 1912, filloi Lufta e Parë Ballkanike, me sulmin e Malit të Zi kundër ushtrisë osmane. Dhjetë ditë më vonë edhe shtetet tjera (Serbia, Bullgaria dhe Greqia) e sulmuan Perandorinë Osmane<sup>10</sup>. Ata sulmuan jo vetëm territoret e banuara nga bashkëkombësit e tyre por edhe territoret shqiptare. Depërtimi i ushtrive aleate në thellësi të tokave shqiptare, alarmoi diplomacinë vjeneze. Prania e tyre në Shqipëri, nuk i konvenonte jo vetëm Austro-Hungarisë por edhe Italisë<sup>11</sup>. Por, qeveria austro-hungareze ishte më e vendosur për të kundërshtuar këtë agresion. Në fund të tetorit 1912, Berchtoldi i kërkoi ambasadorit të tij në Berlin, Szögyeny-t, që të siguronte mbështetjen e Gjermanisë për mbrojtjen e interesave vitale të Austro-Hungarisë, të cilat, sipas tij, ishin të lidhura ngushtë me një “*zhvillim të lirë të Shqipërisë*”<sup>12</sup>. Ministri i Jashtëm austro-hungarez interesohej vetëm për Shqipërinë. Ai nuk shprehej kundër ndryshimeve territoriale në Ballkan, përderisa Shqipëria nuk do të prekej prej tyre dhe për sa kohë asnjë shtet nuk do të pushtonte territore në bregdetin lindor të Adriatikut<sup>13</sup>.

Në fillim të nëntorit 1912, ambasadori rus i akredituar në Austro-Hungari, zhvilloi një takim me ministrin e Jashtëm, Berchtold. Sipas udhëzimeve që kishte marrë paraprakisht nga ministri i tij i Punëve të Jashtme, Sazonov, ambasadori i parashtrroi disa pyetje Berchtoldit. Ndër të tjera, ai e pyeste ministrin e Jashtëm se çfarë qëndrimi do të mbante qeveria e tij nëse shtetet ballkanike do t'i ndanin midis tyre tokat që ata i kishin pushtuar? Si do të reagoonte Vjena nëse Shkupi do t'u mbetej serbëve? A do të dëshironte Vjena t'i pengonte bullgarët për të mos vajtur deri në Stamboll? etj. Në lidhje me pyetjet e mësipërme, Berchtold, theksonte se marshimi i bullgarëve drejt Stambollit nuk kishte ndonjë rëndësi për Austro-Hungarinë. Vjena nuk kundërshtonte

<sup>9</sup> Murzaku, Thoma, *Politika e Serbisë...*, f. 104.

<sup>10</sup> Schevill, Ferdinand. 2002. *Ballkani- Historia dhe qytetërimi*. Tiranë: Uegen, f. 384; Reuter, Jens. 2003. *Shqiptarët në Jugosllavi*. Tiranë: Botimpex, f. 28; Malcolm, Noel. 2001. *Kosova-një histori e shkurtër*. Prishtinë: KOHA, Tiranë: Shtëpia e Librit, f. 261-262.

<sup>11</sup> Јелић, Милосав. 1931. *Албанија- Записи о људима и догађајима*, Београд, с. 6.

<sup>12</sup> Prela, Zef, *Problemi shqiptar dhe politika...*, f. 188; Rappaport, Alfred, *vep. e përm.*, f. 21-22.

<sup>13</sup> Gjermani, Sokol. 2008. Qëndrimi i Austro-Hungarisë ndaj Kryengritjes së vitit 1912. Në *Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek. XX*, (Përmbledhje studimesh). Tiranë, f. 81.

ndarjen e territoreve të pushtuara nga Aleatët Ballkanikë, me kusht që të mos cenoheshin interesat ekonomike të saj dhe që populli shqiptar “*të bëhej më vete ashtu si të tjerët*”. Kurse, në lidhje me të ardhmen e Shkupit, ai theksonte se nuk kishte kundër që ai qytet t’u mbetej serbëve<sup>14</sup>. Në një telegram që Berchtold u dërgonte përfaqësuesve të tij diplomatik, posaçërisht ambasadorit Thurn në Petërburg, më 8 nëntor 1912, në lidhje me qëndrimet që duhej mbajtur për çështjen shqiptare në përgjithësi dhe për aspiratat aneksioniste të Serbisë, theksonte se qeveria e tij nuk kishte shkaktuar asnjë pengesë në operacionet luftarake në sanxhakun e Novi Pazarit dhe “*nuk duam t’i pengojmë aspiratat e saj (Serbisë-shënimi ynë) tokësore as atje as në Serbinë e Vjetër (Kosovë), deri sa të mos cenohen interesat tona ekonomike...*”. Por, në telegramin e tij ai theksonte se nuk mund të pranonte kërkesën serbe për zgjerim deri në Adriatik, përmes tokës shqiptare për të siguruar dalje në port, pasi binte në kundërshtim me idenë e krijimit të një Shqipërie autonome. Copëtimi i mëtejshëm i territorit shqiptar dhe zvogëlimi i tij do ta pamundësonte ekzistencën e Shqipërisë, për çka Austro-Hungaria dhe Italia kishin interesa të mëdha<sup>15</sup>. Qëndrimi i Vjenës në lidhje me Shkupin, pjesën më të madhe të Kosovës dhe sanxhakun e Novi Pazarit sigurisht imponohej edhe nga situata e re e krijuar në Ballkan. Ushtritë serbe kishin depërtuar thellë në territoret shqiptare dhe ishte e vështirë që Vjena të gjente mbështetje të aleatët e saj për përfshirjen e këtyre territoreve brenda shtetit të ardhshëm shqiptar. Gjithashtu, interes parësor i Vjenës ishte mbrojtja e territoreve shqiptare në pjesën perëndimore, të cilat i konsideronin pjesë të zonës së tyre të ndikimit.

Pushtimi i pjesës më të madhe të territoreve shqiptare nga ushtritë e aleatëve ballkanikë, i shtyu disa përfaqësues shqiptarë, që nga mesi i nëntorit ndodheshin në Durrës, t’i drejtonin një lutje perandorit të Austro-Hungarisë, Franc Jozefit I\*. Të vetëdijshëm se të gjitha çështjet e pazgjidhura në Ballkan, trajtoheshin nëpër forumet evropiane, të cilat vendosnin fatin e ballkanasve, përfaqësuesit shqiptarë kërkonin që

<sup>14</sup> AIH, Vj. 22-23-2340. Raport dite, nr. 4282, mbi një vizitë të ambasadorit rus te Berchtoldi. Budapest, më 5 nëntor 1912.

<sup>15</sup> AIH, Vj. 22-23-2362. Telegram i përsëritur i ministrit Berchtold, për përfaqësuesit diplomatik austro-hungarezë. Budapest, Vjenë, më 8 nëntor 1912.

\* Franc Jozefi I (Franz Joseph I), lindi në vitin 1830 dhe vdiq në moshën 86 vjeçare, në vitin 1916. Nga 2 dhjetori 1848 derisa vdiq më 21 nëntor 1916, ishte perandor i Perandorisë Habsburge (Austriake, nga 1867 Austro-Hungareze). Pas kompromisit të arritur me Hungarinë, nga 8 qershori 1867, krahas titullit perandor i Austrisë, mbajti njëkohësisht edhe titullin mbret i Hungarisë.

Austro-Hungaria të mos lejonte pushtimin e tokave shqiptare nga fqinjët ballkanikë. Ata kërkonin që të sigurohej një autonomi e gjerë në kuadër të Perandorisë Osmane, si një variant më i pranueshëm për Fuqitë e Mëdha ose nëse osmanët do të largoheshin përfundimisht nga Ballkani, atëherë të sigurohej pavarësia e Shqipërisë<sup>16</sup>. Sipas nënkonsullit austro-hungarez në Durrës, von Rudnay shqiptarët ishin të bindur “*për mbarimin definitiv të sundimit osman në Shqipëri*” dhe se paria myslimane shpresonte në realizimin e pavarësisë, duke u bazuar në ndihmën austro-hungareze. Ata dëshironin që Shqipëria përkohësisht të vihej nën sovranitetin e Austro-Hungarisë, por se dëshirë e tyre ishte një Shqipëri e pavarur dhe neutrale, sipas modelit të Zvicrës<sup>17</sup>.

Pushtimet territoriale që kryen Aleatët, shqetësoi qarqet qeveritare në Vjenë. Tanimë u bë e qartë se *status quo*-ja në Ballkan nuk mund të ruhej. Ushtritë aleate kishin pushtuar pjesën më të madhe të territoreve shqiptare dhe vazhdonin marshimin drejt territoreve ende të papushtuara. Kështu, Austro-Hungaria rrezikonte t’i humbte edhe territore shqiptare perëndimore, të cilat i konsideronte pjesë të zonës së saj të ndikimit. Prandaj në Ministrinë e Punëve të Jashtme, u shqyrtua gjendja e krijuar pas fillimit të Luftës. Atje u mor një vendim sekret mbi “*interesat vitale dhe sekondare austriake në Ballkan*”, sipas të cilit ishte interes “*vital i Monarkisë*”, të pengohej vendosja e çfarëdolloj Fuqie të Madhe apo të vogël, në brigjet e Adriatikut dhe të Jonit. Për arritjen e këtij qëllimi, u konstatua se do të përdoreshin jo vetëm mjetet diplomatike, por do të “*zbatoheshin gjithashtu edhe masat më ekstreme*”. Sipas vendimit në fjalë, Ballhausplatz\*, do të insistonte në krijimin e shteti autonom shqiptar, por në rast të “*pushimit tërësisht*” të sovranitetit osman në Ballkan, atëherë do të formohej një “*Shqipëri independente*”, e cila do të ishte e dëshirueshme të kishte shtrirje sa më të gjerë në Lindje, megjithëse kjo do të ishte e vështirë të realizohej, pas pushtimeve të kryera nga shtetet ballkanike<sup>18</sup>.

<sup>16</sup> *AIH*, Vj. 22-6-697. Shtojca e një relacioni nr. 74/1, të konsullatës në Durrës. (Lutje e delegatëve shqiptarë të ndodhur në Durrës drejtuar madhërisë së tij Franz Josef I). Durrës, më 13 nëntor 1912.

<sup>17</sup> *AIH*, Vj. 22-8-821. Telegram shifër i nënkonsullit në Durrës, von Rudnay për Vjenën, Stambollin dhe Shkodrën. Durrës, më 12 nëntor 1912.

\* **Ballhausplatz** quhej sheshi në qendër të Vjenës në të cilin ndodhej Ministria e Punëve të Jashtme e Austro-Hungarisë. Prandaj, shpeshherë me emrin e këtij sheshi identifikohet kjo ministri.

<sup>18</sup> *AIH*, A-IV-175. Një vendim sekret i Ministrisë së Jashtme austro-hungareze mbi interesat vitale dhe sekondare austriake në Ballkan në kohën e krizës ballkanike 1912.



Qeveria vjeneze kërkonte nga aleatët e Lidhjes Trepalëshe, që të përkrahnin qëndrimin e saj, në lidhje me çështjen shqiptare. Nëpërmjet një telegrami, më 17 nëntor 1912, Berchtoldi kërkonte nga ministri i Jashtëm italian di San Giuliano që të dakordoheshin midis tyre për të ardhmen e Shqipërisë. Ai theksonte se ishte e nevojshme që të fiksonin një program relativ, i cili do të përmbante nga njëra anë aftësinë për të jetuar të shtetit të ardhshëm shqiptar por nga ana tjetër duhej të merreshin në konsideratë edhe rezultatet e operacioneve ushtarake. Sipas tij Gjakova, Peja, Prizreni të banuara në shumicë nga shqiptarët do të ishte e dëshirueshme të ishin pjesë e Shqipërisë së ardhshme. Në Juglindje Mbretëria greke të zgjerohej afërsisht deri në lumin Kallama. Në Veriperëndim të diskutohej kërkesa malazeze\* për Shkodrën<sup>19</sup>. Në bazë të kërkesave të përsëritura të Vjenës, qeveria e Romës dhe ajo e Berlinit, i deklarorin Serbisë se ato solidarizoheshin me qëndrimin e Austro-Hungarisë në lidhje me çështjen shqiptare. Ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Kiderlen, deklaronte në emër të tri Fuqive të Trepalëshit, se ato “*do ta kundërshtonin energjikisht daljen e Serbisë në detin Adriatik*”. Nga ana tjetër, Roma ishte e detyruar të përkrahte qëndrimin e Vjenës ndaj çështjes shqiptare, pasi nuk dëshironte që t’i linte pozita të favorshme Austro-Hungarisë, në Shqipëri dhe në Ballkan. Diplomatat italianë, kryeministri Xholiti (Giovanni Giolitti) dhe ministri i Punëve të Jashtme markezi San Xhuliano (marchese di San Giuliano) pohonin se Italia nuk do të lejonte daljen e Serbisë në Adriatik dhe se do të “*favorizonte formimin e Shqipërisë autonome*”<sup>20</sup>.

Megjithëse, Austro-Hungaria dhe Italia ishin aleate midis tyre dhe kishin interes të përkrahnin krijimin e një shteti të pavarur shqiptar, prapëseprapë Italia tregohej e gatshme t’i bënte më tepër koncesione Serbisë, në lidhje me pretendimet e saj territoriale. Në një projekt të saj,

\* Megjithëse në fillim ministri i Punëve të Jashtme i Austro-Hungarisë pranonte që çështja e Shkodrës të diskutohej me qeverinë malazeze, më vonë ai këmbënguli që ajo t’i mbetej Shqipërisë me çdo kusht. Nga fundi i nëntorit Berchtold konsideronte se Shkodra ishte qendra më e rëndësishme për shqiptarët e Veriut. Shkëputja e saj nga Shqipëria rrezikonte “*edhe humbjen e thuajse të gjithë katolikëve shqiptarë*”. Në një bisedë me ambasadorin italian në Vjenë, Dukën e Avarnës, ministri i Jashtëm austro-hungarez kishte theksuar “*se të gjitha çështjet që kanë lidhje me Shqipërinë kanë rëndësi vitale për ne*” (Shih: AIH, Vj. 22-7-727. Telegram shifër i ministrit Berchtold për ambasadorin në Romë. Vjenë, më 30 nëntor 1912). Në pranverë 1913, ai kërcënoi se do ta tërhiqte përfaqësuesin e tij nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe do ta përdorte forcën ushtarake për ta detyruar ushtrinë malazeze të tërhiqej nga Shkodra.

<sup>19</sup> Verli, Marenglen & Dushku, Ledia. 2012. *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912), Vëllimi VI*. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, f. 221-222.

<sup>20</sup> Prella, Zef, *Problemi shqiptar dhe politika...*, f. 191-192, 195.

të 26 nëntorit, ajo kundërshtonte projektin austro-hungarez, i cili parashikonte krijimin e “*Shqipërisë së madhe*”. Sipas qeverisë italiane, Serbisë duhej t’i njiheshin më shumë koncesione si dhe të krijohej një shtet neutral shqiptar nën kontrollin e huaj. Për italianët, ishte e pamundur që shqiptarët të “*jetonin të pavarur*”<sup>21</sup>. Nëpërmjet një shkrese private, ambasadori austro-hungarez në Romë, Mérey theksonte se aleanca e qeverisë italiane me atë të Vjenës, në lidhje me çështjen shqiptare ishte artificiale. Megjithëse, autonomia e Shqipërisë gëzonte simpati në Itali, ata nuk dëshirojnë të filloj një luftë evropiane për këtë çështje. Prandaj, sipas tij, mbështetja e italianëve për Shqipërinë kishte filluar të zbehej. Gjithashtu, ata ishin të bindur se “*Shqipëria që do të krijohet do të jetë një foshnjë e dështuar nga shkaku se pothuajse copat më të majme po ia grabisin që më parë Mali i Zi, Serbia dhe Greqia...*”. Në Itali ishin të bindur se tre shtetet ballkanike “*të cilat filluan ta hanë Shqipërinë që sot, do ta gëlltisnin nesër që të gjithën*”<sup>22</sup>. Më 21 nëntor, Berchtold zhvilloi dy takime me ambasadorët e Gjermanisë dhe të Italisë në Vjenë. Ambasadori gjerman, kishte theksuar se qeveria e tij mendonte se Fuqitë e Trepalëshit do të duhej të bënin demarsh në Beograd duke deklaruar se ishin kundër aneksimit të bregdetit shqiptar nga Serbia dhe se këtë qëndrim t’ua komunikonin në konfidencë edhe Fuqive të tjera. Me qëndrimin e qeverisë gjermane nuk ishte dakord ambasadori italian. Ky i fundit mendonte se nuk kishin arsye për demarsh në Beograd, pasi sipas tij ky veprim do të pritej negativisht nga opinioni publik, kurse në lidhje me komunikimin që duhej bërë qeverive të Fuqive të tjera të Mëdha, kishte deklaruar se për këtë çështje i duhej të konsultohet me qeverinë e tij<sup>23</sup>.

Austro-Hungaria ua bëri të qartë edhe Fuqive të Antantës, se ajo nuk do të lejonte Serbinë t’i realizonte tërësisht synimet e saj ndaj territoreve shqiptare. Në një takim, që diplomati austro-hungarez i akredituar në Paris, konti Seçen (Szécsen), zhvilloi me Kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm francez, Raymond Poincaré, më 6 nëntor, e njoftoi atë me qëndrimin e Vjenës, në lidhje me të ardhmen e Shqipërisë. Sipas tij, qeveria austro-hungareze ishte e vendosur “*të mos lejonte asnjë dalje të Serbisë në Adriatik*”. Qeveria e tij, vinte në dukje diplomati në fjalë, kundërshtonte krijimin e një Shqipërie të vogël, ashtu siç parashikonte ministri i Jashtëm rus, Sazonov. Szécsen, vinte në dukje

<sup>21</sup> *Po aty*, f. 204.

<sup>22</sup> AIH, Vj. 22-24-2472. Shkresë private e ambasadorit Mérey. Romë, më 20 nëntor 1912.

<sup>23</sup> AIH, Vj. 22-24-2477. Raport dite i kontit Berchtold rreth takimeve të zhvilluara me ambasadorët e Italisë dhe të Gjermanisë. Vjenë, më 21 nëntor 1912.

se duhej të krijohej një “*Shqipëri me mundësitë e ekzistencës dhe zhvillimit*”<sup>24</sup>. Më 28 nëntor, Berchtold në një telegram që i dërgonte ambasadorit të tij në Berlin theksonte se qeveria e tij kundërshtonte dëshirën e Serbisë për të siguruar dalje në një liman në Adriatik, nëpërmjet “*tokave thjesht shqiptare*” dhe se ky qëndrim ishte në harmoni të plotë me Italinë<sup>25</sup>. Të njëjtin qëndrim mbajti edhe ndaj pretendimeve të qeverisë greke. Në lidhje me kërkesat e kësaj të fundit për të marrë territoret shqiptare deri në veri të Tepelenës, duke përfshirë Vlorën e Voskopojën, ministri i Punëve të Jashtme i Austro-Hungarisë deklaronte se do t’i kundërshtonte “*me gjithë shpirt*” pretendimet e tilla dhe se të njëjtën gjë e priste edhe nga Italia<sup>26</sup>.

Kundërshtimi i vendosur i qeverisë së Vjenës për të mos e lejuar Serbinë të siguronte dalje në det nëpërmjet territorit shqiptar, i detyroi edhe aleatët e qeverisë serbe në ishin të kujdesshëm në raport me kërkesat e Beogradit. Megjithëse Rusia dhe Franca dëshironin që Serbia të merrte sa më tepër toka shqiptare, përballë presionit të Vjenës, ato u detyruan t’i këshillonin serbët të ishin më të përmbajtur në kërkesat e tyre. Më 13 nëntor 1912, diplomati serb në Bukuresht, Ristiç, shkruante se miqtë e tyre francez dhe rus i këshillonin që të mos e “*tepronin për sa i përket një dalje në Adriatik*”<sup>27</sup>, sepse kjo kundërshtohej me vendosmëri nga Vjena.

Njëri nga intelektualët shqiptarë të kohës, Eqrem bej Vlora, në kohën kur Lufta e Parë Ballkanike kishte filluar, ndodhej në Vjenë. I shqetësuar për zhvillimin e ngjarjeve në Ballkan dhe për të ardhmen e Shqipërisë ai i drejtoi disa pyetje qeverisë së austro-hungareze. Eqrem beu, u interesua nëse qeveria austro-hungareze do të ishte në gjendje të garantonte: bregdetin shqiptar deri në Prevezë, përfshirjen e territoreve shqiptare brenda kufijve të Shqipërisë së ardhshme? Nëse Austro-Hungaria, në Konferencën Ndërkombëtare që do të mbledhej për të vendosur për të ardhmen e Ballkanit, do të dështonte në përpjekjet e saj për të siguruar integritetin e Shqipërisë, a do të ishte në gjendje ajo që të përkrahte një “*rezistencë nacionale*” të shqiptarëve? A mendonte Austro-Hungaria ta pushtonte Shqipërinë? etj. Në përgjigje të pyetjeve të mësipërme, qeveria austro-hungareze theksonte se kishte si

<sup>24</sup> Poincaré, Raymond. 2006. *Lufta e parë dhe e dytë Ballkanike si dhe konferenca e Londrës (1912-1913)*. Shkup-Prishtinë-Tiranë: Logos-A, f. 298.

<sup>25</sup> Verli, Marenglen & Dushku, Ledia, *vep. e përm.*, f. 366.

<sup>26</sup> AIH, Vj. 22-25-2541. Telegram i Berchtoldit për ambasadorin Mérey në Romë. Vjenë, më 27 nëntor 1912.

<sup>27</sup> Durham, Edith. 2001. *Njëzet vjet ngatërresa ballkanike*. Tiranë, f. 267.

pikësytin mbrojtjen e interesave të Shqipërisë “*të paktën deri në lumin Kallama*”. Nëse përpjekjet e Vjenës në Konferencën Ndërkombëtare, nuk do të përfundonin me sukses, për mbrojtjen e interesave të Shqipërisë, atëherë ajo do ta “*përkrahte fshehurazi rezistencën nacionale*”. Në lidhje me një pushtim të mundshëm të Shqipërisë nga Austro-Hungaria, theksohej se një gjë e tillë nuk do të ndodhte “*në asnjë mënyrë*”<sup>28</sup>.

Nga takimet e mësipërme, të zhvilluara me diplomatët vjenezë, Eqrem bej Vlora arriti, ndër të tjera, në këto përfundime: së pari, në rast se trupat osmane do të shpartalloheshin nga ato aleate, atëherë shqiptarët duhej të organizonin urgjentisht një Kuvend, i cili do të shpallte pavarësinë dhe asnjësinë e Shqipërisë. Së dyti, Austro-Hungaria edhe në rast fitoreje osmane, në Luftën Ballkanike, do të mbështeste idenë e “*autonomisë shqiptare*”. Së treti, në rast se ushtritë osmane pësonin disfatë të plotë, Vjena do të “*njihte dhe mbronte ekzistencën e një Shqipërie të lirë e të pavarur*”<sup>29</sup>.

Pushtimet e kryera nga shtetet ballkanike në Shqipëri, i bindën udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, se e vetmja rrugë e shpëtimit të popullit shqiptar ishte shpallja e pavarësisë së plotë, pasi Perandoria Osmane nuk kishte gjasa të mbante çfarëdo pushteti në pjesën evropiane. Prandaj, krerët e Lëvizjes Kombëtare vazhduan përpjekjet e tyre për të siguruar përkrahje të jashtme, për realizimin e këtij synimi. Në radhë të parë mbështetja për një veprim të tillë do të kërkohej nga Austro-Hungaria. Në fund të tetorit 1912, Ismail Qemali, bashkë me disa atdhetarë të tjerë si: Luigj Gurakuqin, Kristo Meksini, Dhimitër Beratin etj., u nis nga Stambolli për në Bukuresht, ku ndodhej kolonia më e madhe shqiptare e asaj kohe. Atje ai u takua me të dërguarin austro-hungarez në kryeqytetin rumun, princin K. E. Fyrstenberg (Fürstenberg), nga i cili kërkoj që t’i raportonte Ministrisë së Jashtme që ajo ta mbështeste në ndërmarrjen e tij. Vjena e ftoi menjëherë për bisedime<sup>30</sup>. Para nisjes për në kryeqytetin austro-hungarez, ai i deklaroi një gazetari italian se nuk shihte ndonjë zgjidhje të problemit shqiptar, përveçse një ndërhyrjeje austro-hungareze<sup>31</sup>. Në atë

<sup>28</sup> AIH, Vj. 22-11-1137. Bisedimet me Eqrem bej Vlorën prej 15-19 tetor 1912; Po aty, Vj. 22-11-1145. Përgjigjet e projektuara për pyetjet që bëri Eqrem bej Vlora. Vjenë, 1912.

<sup>29</sup> Vlora, Eqrem bej. 2003. *Kujtime 1885-1925*. Tiranë: Shtëpia e Librit & Komunikimit, f. 288.

<sup>30</sup> Nika, Nevila, *vep. e përm.*, f. 301.

<sup>31</sup> Skendi, Stavro. 2000. *Zgjimi Kombëtar Shqiptar 1878-1912*. Tiranë: PHOENIX & Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, f. 412.

kohë, Ismail Qemali besonte se Austro-Hungaria ishte e vetmja Fuqi mbrojtëse e Shqipërisë<sup>32</sup>.

Në nëntor, Ismail Qemali, shkoi në Vjenë për të biseduar me kabinetin austro-hungarez, në lidhje me rrethanat e reja të krijuara në Ballkan, në të cilat, shpallja e autonomisë në suaza të Perandorisë Osmane ishte e pamundur. Në Austro-Hungari, ai zhvilloi bisedime të niveleve të ndryshme me përfaqësues të disa Fuqive e veçanërisht me Berchtoldin, shefin e diplomacisë austro-hungareze<sup>33</sup>. Pas sigurimeve të mara në Vjenë, më 9 nëntor ai dërgoi një telegram në Vlorë, në të cilin thuhej; “*E ardhmja e Shqipërisë është siguruar... ruani qetësinë. I epni rretheve lajmin e gëzueshme...*”<sup>34</sup>. Takimin e parë ai e zhvilloi më 12 nëntor në Ballhausplatz. Në bisedat e zhvilluara me diplomatët austro-hungarezë, udhëheqësi shqiptar theksoi se bashkëkombësit e tij dëshironin pavarësinë e Shqipërisë, pasi kjo ishte rruga e vetme për vendosjen e qetësisë në Gadishullin Ballkanik. Rappaport, i cili më 1912 ishte referent për të gjitha çështjet shqiptare, pranë qeverisë austro-hungareze<sup>35</sup>, deklaroi se qeveria e tij gjithmonë kishte “*ushqyer simpatinë për zhvillimin nacional të popullit shqiptar*” dhe se dëshiron-te që shqiptarët, të dilnin nga “*ngatërresat ballkanike si një trup kompakt*”. Por edhe në prag të shpalljes së pavarësisë qeveria austro-hungareze vazhdonte ta shihte me dyshim Ismail Qemalin<sup>36</sup>, për shkak të lidhjeve që ai kishte mbajtur në të kaluarën me qeverinë greke dhe simpatitë e shfaqura për politikën italiane. Udhëheqësi shqiptar zhvilloi një bisedë të drejtpërdrejt me ministrin e Jashtëm të Austro-Hungarisë, Berchtoldin. Në “*Kujtimet*” e tij, ai shkruan se kur arriti nga Bukureshti në Vjenë mori një telegram nga një “*mik personal*” i tij në Budapest, i

<sup>32</sup> Vickers, Miranda. 2004. *Midis serbëve dhe shqiptarëve- një histori e Kosovës*. Tiranë: TOENA, f. 104.

<sup>33</sup> Puto, Arben. 1984. *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, vëllimi I, (1867-1912)*. Tiranë: 8 Nëntori, f. 79-80.

<sup>34</sup> *Po aty*, f. 103-104; Teuta Hoxha. 2002. *Ismail Qemali, Përmbledhje dokumentesh (1888-1919)*. Tiranë: Mësonjëtorja e Parë, f. 246-247; *Dokumenta Historike për t'i shërbye historisë kombëtare*, botues Lef Nosi, viti i I<sup>rë</sup>, Shtypshkronja “Elbasani”- Elbasan, mars 1924, Nr. 1, f. 5; Murzak, Thoma & Sala, Kozeta. 2008. *Politika e Austro-Hungarisë gjatë vitit të parë të Pavarësisë së Shqipërisë. Në Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek. XX*, (Përmbledhje studimesh). Tiranë, f. 153-154; Arkivi Qendror Shtetëror, Fondi 245/I, Dokumenti 1, f. 5; Verli, Marenglen & Dushku, Ledia, vep. e përm., f. 171.

<sup>35</sup> *Udhëtime nëpër Ballkan- Kujtime nga jeta dhe vepra e Franc Baron Nopça*. 2007. Tiranë: Plejadë, f. 345.

<sup>36</sup> *AIH*, Vj. 22-24-2407. Raport dite, nr. 4398, mbi një vizitë të Ismail Qemalit në Vjenë, më 12 nëntor 1912; *Po aty*, Vj. 22-11-1148. Raport dite, mbi një vizitë të Ismail Qemalit në Vjenë, më 12 nëntor 1912.

cili e ftonte të shkonte në atë qytet për t'u takuar me një “personalitet të lartë”. Në Budapest ai u takua me kontin Hadik, ish-nënkonsulltar shteti. Pikërisht Hadiku i tha se personaliteti që donte të bisedonte me të ishte vetë Berchtoldi. Ismail Qemali u takua me ministrin e Jashtëm po atë mbrëmje në shtëpinë e Hadikut. Lidhur me përmbajtjen e bisedës Ismail Qemali ka shkruar se Berchtoldi i kishte “*aprovuar pikëpamjet (e tij- shënimi ynë) mbi çështjen kombëtare*”. Pas këtij takimi, ministri austro-hungarez i Punëve të Jashtme, ia plotësoi Ismail Qemalit kërkesën për t'i vënë në dispozicion një anije<sup>37</sup> që do ta nxirrte fshehuri, atë dhe bashkëpunëtorët e tij në Durrës, pasi bregdeti shqiptar ishte bllokuar nga flota greke<sup>38</sup>.

Një ditë para se të nisej për në Shqipëri, më 18 nëntor, Ismail Qemali i dërgoi një telegram komisionit përgatitor për Shpalljen e Pavarësisë. Në telegram, ndër të tjera, ai shkruante: “*Përpara të premtes jemi në Durrës. Është e domosdoshme që delegatët të mblidhen në Durrës ose në Vlorë... Çështja jonë politike është siguruar përfundimisht*”<sup>39</sup>.

Më 19 nëntor Ismail Qemali u nis nga Trieste për në atdhe. Para nisjes, ai i deklaroi shtypit se “*me të mbërritur në vend do të Shpallej Pavarësia e Shqipërisë dhe do të formohet Qeveria e Përkohshme*”<sup>40</sup>. Po atë ditë, Berchtoldi i drejtoi nënkonsullit të tij në Durrës, Rudney një telegram, me të cilin e porosiste që të “*tregohej i afrueshëm*” me Ismail Qemalin dhe udhëheqësit tjerë shqiptarë dhe t'u jepte atyre çdo ndihmë kur ata të zbrisnin në Durrës<sup>41</sup>. Më 21 nëntor Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi dhe katër atdhetarë të kolonisë shqiptare në Rumani, arritën në Durrës.

Në mes të nëntorit, pasi morën sigurimet e nevojshme nga Vjena se do të mbështetej pavarësia e Shqipërisë, në Vlorë u mbledh Kuvendi mbarëkombëtar, në të cilin morën pjesë përfaqësues nga të gjitha pjesët

<sup>37</sup> Krah.: Puto, Arben. 1978. *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914*. Tiranë: 8 Nëntori, f. 106-107; Skendi, Stavro, *Zgjimi...*, f. 414; Swire, Joseph. 2005. *Shqipëria- ngritja e një mbretërie*. Tiranë: Dituria, f. 128; Arsh, G. Ll. & I. G. Senkeviç & N. D. Smirnova. 1967. *Histori e shkurtë e Shqipërisë*. Prishtinë: Rilindja, f. 180; Vllamasi, Sejfi. 2000. *Ballafaqimet politike në Shqipëri (1897-1942)*. Tiranë: Neraida, f. 68-69; Zavalani, Tajar. 1998. *Histori e Shqipërisë*. Tiranë: PHOENIX & Shtëpia e Librit, f. 224; Smirnova, Nina. 2004. *Histori e Shqipërisë- përgjatë shekullit XX*. Tiranë: Ideart, f. 57.

<sup>38</sup> Vllamasi, Sejfi, *vep. e përm.*, f. 68-69.

<sup>39</sup> Teuta Hoxha, *vep. e përm.*, f. 247-248.

<sup>40</sup> Prifti, Kristaq. 2008. Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe çështja e një shteti të njësuar kombëtar. Në *Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek. XX*, (Përmbledhje studimesh), Tiranë, f. 22.

<sup>41</sup> Puto, Arben, *Pavarësia shqiptare...*, f. 110.

e Shqipërisë. Pas diskutimeve që u bënë, Kuvendi, më 28 Nëntor 1912, Shpalli Pavarësinë e Shqipërisë.

Në ditën e Shpalljes së Pavarësisë, në një njoftim që Ministria e Jashtme austro-hungareze u dërgonte konsujve të saj në Janinë, Vlorë, Durrës dhe Shkodër, i porosiste ata që pa e kompromentuar pozitën e tyre si përfaqësues të huaj, t'u jepnin të kuptonin krerëve shqiptarë se qeveria italiane dhe ajo austro-hungareze ishin mjaft të interesuara për "*autonominë dhe pavarësinë e Shqipërisë*". Udhëzoheshin konsujt që t'i nxisnin udhëheqësit shqiptarë, që sa më shpejt të formonin një qeveri kombëtare, e cila do të mund t'i drejtohej për ndihmë si qeverisë italiane ashtu dhe asaj austro-hungareze<sup>42</sup>. Pas formimit të qeverisë shqiptare, Ministria e Jashtme i dërgonte një telegram konsullit të saj në Durrës, von Rudney, të cilin e porosiste që të "*këshillonte shqiptarët myslimanë*" që të bashkoheshin me qeverinë e Vlorës, kurse shqiptarët ortodoksë duhej të bindeshin se autonomia nuk do të sillte për ta "*nënshtrimin... nën shqiptarët myslimanë*", pasi qeveria e re do të respektonte interesat dhe të drejtat e të gjithë shqiptarëve pavarësisht cilit besim i përkisnin<sup>43</sup>. Në momentet më të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar, qeveria e Vjenës, i këshillonte shqiptarët e të gjitha besimeve fetare, që ata të ishin të bashkuar, të përkrahnin vendimet e Kuvendit të Vlorës dhe të mos binin pre e propagandave të huaja antishqiptare.

Krahas përkrahjes që u jepej përfaqësuesve shqiptarë, qeveria e Vjenës bënte presion mbi qeveritë e shteteve ballkanike që të përmbaheshin nga synimet e tyre për pushtimin e territoreve shqiptare. Në Vjenë, ishin të bindur se interesat e tyre në Ballkan mund të siguroheshin vetëm nga "*një Shqipëri e pavarur*", që do të pengonte shtrirjen serbe. Ndërsa, ushtria serbe i afrohej bregdetit shqiptar, Vjena paralajmëroi Beogradin, se ajo nuk do të lejonte pushtimin e ndonjë porti detar në Adriatik. Ajo ishte e vendosur të mos lejonte asnjë Fuqi armike të zinte vendin e Portës së Lartë në Shqipëri<sup>44</sup>. Më 12 nëntor, ministri austro-hungarez në Cetinë, kërkoi nga mbreti Nikolla të përmbahej nga operacionet kundër Lezhës dhe Shëngjinit. Gjithashtu, Austro-Hungaria, e përkrahur edhe nga Italia ndërhyri edhe pranë qeverisë serbe, nga e cila kërkoi që të mbante qëndrim të "*moderuar dhe të arsyeshëm*"

<sup>42</sup> Po aty, Vj. 22-14-1427. Njoftim i MPJ për konsujt e saj në Janinë, Vlorë, Durrës dhe Shkodër. Vjenë, më 28 nëntor 1912.

<sup>43</sup> Po aty, Vj. 22-10-1053. Telegram shifër, nr. protokoll. 3841, i MPJ për konsullin në Durrës, von Rudney. Vjenë, më 10 dhjetor 1912.

<sup>44</sup> Vickers, Miranda, *vep. e përm.*, f. 109-111.

dhe njëkohësisht ia bëri të qartë se nuk do të toleronte një port ushtarak serb në Adriatik<sup>45</sup>. Insistimi i Vjenës për të penguar pushtimin e bregdetit shqiptar nga Serbia dhe mbështetja që ajo u jepte shqiptarëve, irritoi serbët. Pas pushtimit të Prizrenit nga ushtria serbe dhe dhunës që këta kishin ushtruar mbi popullsinë e pambrojtur shqiptare, konsulli austro-hungarez në atë qytet, Prochaska, kishte marrë nën në konsullatën e tij disa shqiptarë. Si kundërpërgjigje serbët e keqtrajtuan konsullin<sup>46</sup>. Gjithashtu ata shkatërruan kishat katolike shqiptare, me arsyetimin se ato ishin “*ndërtesa austriake prandaj duheshin fshirë*”<sup>47</sup>.

Austro-Hungaria kishte interes ta mbështeste krijimin e një shteti të pavarur shqiptar. Interesat e saj në Ballkanin Jugor mund të siguroheshin vetëm nga një Shqipëri e pavarur, e cila do të pengonte shtrirjen territoriale serbe<sup>48</sup>. Kur Aleatët Ballkanik kishin pushtuar pjesën më të madhe të territoreve të Turqisë Evropiane, Rusia dhe Franca u bënë presion Fuqive të tjera të Mëdha që të bënin një deklaratë “*çinteresimi*”, pra t’u njihnin monarkive ballkanike pushtimet e kryera. Por, Vjena refuzoi e indinjuar ta merrte parasysh këtë propozim. Qëndrimi i Vjenës u përkrah edhe nga Italia dhe Britania e Madhe. Për këtë veprim, Ismail Qemali i falënderoi personalisht konsujt austro-hungarez dhe italian në Vlorë dhe, me një letër edhe ministrin e Jashtëm britanik, Edward Grey-in<sup>49</sup>.

Menjëherë pas Shpalljes së Pavarësisë, më 28 dhe 29 nëntor 1912, Ismail Qemali, në cilësinë e kryetarit të Qeverisë së Përkohshme, u dërgoi nga një telegram qeverive të Fuqive të Mëdha, atyre të shteteve ballkanike dhe Portës së Lartë, të cilat i njoftonte për realitetin e ri të krijuar në Ballkan dhe njëkohësisht kërkonte prej tyre njohjen e këtij ndryshimi në hartën politike të Evropës Juglindore<sup>50</sup>.

Në përgjigje të kërkesës së mësipërme, nëpërmjet një telegrami, ministri i Jashtëm austro-hungarez, Berchtold, e njoftonte konsullin e tij në Vlorë, Lejhanec, se qeveria e Vjenës së bashku me qeverinë e Romës, ishin të interesuara për “*zhvillimin independent të Shqipërisë*” dhe shprehnin gatishmërinë t’i jepnin Qeverisë së Përkohshme

<sup>45</sup> Swire, Joseph, *vep. e perm.*, f. 128.

<sup>46</sup> Durham, Edith, *vep. e perm.*, f. 247.

<sup>47</sup> Freundlich, Leo. 1995. *Golgota shqiptare- Akuza kundër shfarosësve të popullit shqiptar*. Tiranë: Lilo, f. 63.

<sup>48</sup> Vickers, Miranda, *vep. e perm.*, f. 109-110.

<sup>49</sup> Swire, Joseph, *vep. e perm.*, f. 128.

<sup>50</sup> Murzaku, Thoma, *Politika e Serbisë...*, f. 171-172.



“ndihmën e tyre morale”<sup>51</sup>. Me një telegram tjetër, që Ballhausplatzi u dërgonte konsullit Lejhanec në Vlorë dhe nënkonsullit Rudney në Durrës, i udhëzonte ata që t’i njoftonin udhëheqësit shqiptarë, se qeveria austro-hungareze dhe ajo italiane mbështesnin autonominë dhe pavarësinë e Shqipërisë. Kërkohej nga përfaqësuesit konsullorë që t’i këshillonin udhëheqësit shqiptarë, që sa më shpejt të formonin “një komitet të përbërë nga personalitetet më të shquara”, me të cilin do të mund të kontaktonin qeveritë e të dyja vendeve<sup>52</sup>.

Një javë pas shpalljes së pavarësisë, konsujt e Austro-Hungarisë dhe të Italisë në Vlorë, u paraqitën para kryetarit të Qeverisë së Përkohshme, Ismail Qemalit, për t’i njoftuar zyrtarisht nga ana e qeverive të tyre respektive se ato do të mbështesnin shtetin e ri shqiptar<sup>53</sup>.

Pas shpalljes së Pavarësisë, qeveria austro-hungareze dhe ajo italiane vazhduan të përkrahnin udhëheqësit shqiptarë në përpjekjet e tyre për konsolidimin e shtetit shqiptar. Nëpërmjet një telegrami që Ballhausplatzi u dërgonte konsujve të saj të akredituar në Shqipëri, i udhëzonte ata që të kërkonin nga Bib Doda që t’u shmangej veprimeve të veçuara dhe të bashkëpunonte me krerët tjerë shqiptarë “për konsolidimin e autonomisë së Shqipërisë”. Nëpërmjet të njëjtit telegram, udhëzoheshin konsujt që ta njoftonin Ismail Qemalin, që ai vetë të mos bëhej pjesë e delegacionit shqiptar që do të vizitonte qeveritë e Fuqive evropiane. Berchtold vlerësonte se ishte e nevojshme që në cilësinë e kryeministrit të qëndronte në Shqipëri. Sipas ministrit të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, qeveria shqiptare të dërgonte një komision, i cili do të përfaqësonte atë në takimet me diplomatë evropianë dhe se ky delegacion do të ndihmohej nga qeveritë e Austro-Hungarisë dhe Italisë<sup>54</sup>.

Ndërsa i këshillonte udhëheqësit shqiptarë për unitet, në anën tjetër e vazhdonte angazhimin e saj diplomatik për ta përkrahur çështjen shqiptare në raportet me Fuqitë e tjera. Në një përkujtesë që qeveria austro-hungareze i dërgonte Shën Peterburgut, në ditën e Krishtlindjeve, ndër të tjera vinte në dukje se Austro-Hungaria kishte “interes jetësor” në “krijimin e një Shqipërie të aftë të mbijetojë” dhe se humbja

<sup>51</sup> AIH, Vj. 22-8-864. Telegram në shifra, nr. 3648, i ministrit të Jashtëm austro-hungarez, dërguar konsullit të tij në Vlorë, Lejhanec. Vjenë, më 1 dhjetor 1912.

<sup>52</sup> Po aty, Vj. 22-7-720. Telegram në shifra, nr. 3657 dhe 3658, i Ministrisë së Punëve të Jashtme për konsullin Lejhanec në Vlorë dhe nënkonsullin Rudney në Durrës. Vjenë, më 1 dhjetor 1912.

<sup>53</sup> Frashëri, Mid’hat. 1999. *Fati i Shqipërisë*. Tiranë: Lumo Skëndo, f. 61.

<sup>54</sup> AIH, Vj. 22-14-1419. Telegram nr. 766 i Ministrisë së Punëve të Jashtme, i cili nuk bëhet i qartë se cilëve konsuj u dërgohej. Vjenë, 1912.

e Shkodrës i shkaktonte dëm të madh Shqipërisë<sup>55</sup>. Austro-Hungaria dëshironte një Shqipëri sa më të madhe, e cila do të bëhej “një pykë e futur midis sllavëve të Jugut”<sup>56</sup>.

Qeveria e Vjenës bëri përpjekje të sensibilizonte opinionin publik evropian mbi masakrat që kryenin ushtritë serbe mbi popullsinë e pambrojtur shqiptare, të territoreve të pushtuara. Në telegramet që ministri i Jashtëm, Berchtold, i dërgonte në kryeqytetet e Fuqive të Mëdha, vihej në dukje se ushtria serbe kishte “masakruar popullsinë myslimane (shqiptarëshërimi ynë)”, në Shkup, Kumanovë e Ferizaj. Sipas telegrameve në fjalë, trupat e shqiptarëve të vrarë, më pas ishin hedhur në lumë. Ndonëse nuk bëhet e qartë se kujt i drejtoheshin këto telegrame, nga përmbajtja e tyre kuptojmë se ato u ishin adresuar diplomatëve austro-hungarezë të akredituar në ato kryeqytete. Në fund të telegrameve theksohej se “do të na pëlqente fort, po të trumbetohej në botë sjellja barbare e serbëve kundrejt shqiptarëve”, por të mos kuptohej “se këto informacione buronin nga diplomacia austro-hungareze”, pasi ata mund të akuzoheshin se të njëjtat i kishin “përhapur me paramendim”<sup>57</sup>.

Megjithëse Austro-Hungaria, vazhdimisht kishte shprehur dashamirësinë e saj ndaj kërkesave të popullit shqiptar, arsyeja pse ajo mbështeste zhvillimin kulturor të tyre dhe nuk mbështeti hapur kryengritjet shqiptare të viteve 1909-1912, sipas princ Lichtenstein, anëtar i Komitetit austriak për Shqipërinë\*, ishte se të kërkoje në atë kohë pavarësinë e Shqipërisë, do të thoshte të “shtroje për zgjidhje çështjen turke në Evropë”, e cila do të sillte një situatë të rrezikshme politike<sup>58</sup>, për të cilën nuk ishin të përgatitur Perandoria e Dyfishtë dhe aleatët e saj.

Ndihma që qeveria e Vjenës i dha çështjes shqiptare në Konferencën e Ambasadorë në Londër, në vitet 1912-1913, ishte vendimtare, pasi këmbëngulja e ambasadorit të saj, Mensdorf, pengoi një copëtim edhe më të madh të territoreve shqiptare. Sipas Leopold von

<sup>55</sup> Poincaré, Raymond, *vep. e përm.*, f. 411.

<sup>56</sup> Skendi, Stavro, *Mendimi politik...*, f. 31.

<sup>57</sup> *AIH*, Vj. 22-24-2484. Telegramet të Berchtoldit për në: Telegrami nr. 4545, nuk bëhet e qartë për ku drejtohej; Telegram nr. 19 (1), për në Romë; Telegram nr. 21 (2), për në Berlin; Telegram nr. 10 (3), për në Paris; Telegram nr. 11 (4), për në Londër dhe Telegram nr. 15 (5), për në Petrograd. Budapest, Vjenë, më 21 nëntor 1912.

\* Në dokument nuk jepen të dhëna mbi kohën e themelimit të Komitetit austriak për Shqipërinë. Komiteti përbëhej nga katër seksione: letrar, shkencor, ekonomik dhe humanitar dhe kishte për qëllim të ndihmonte shtetin e ri shqiptar dhe në përgjithësi popullin shqiptar, në fushat e mësipërme.

<sup>58</sup> *AIH*, A-V-103. Lichtenstein, Qëllimi dhe pikësnyimi i Komitetit austriak për Shqipërinë. (Vepër në dorëshkrim, e cila ndodhet pranë Arkivit të Institutit të Historisë në Tiranë).

Chlumecky, ishte në interesin e Austro-Hungarisë të krijohej një shtet i pavarur shqiptar, me kufij sa më të gjerë. Pushtimin e bregdetin lindor të Adriatikut nga shtetet sllave ai e konsideronte si “*falimentim të politikës... adriatike*” të qeverisë së Vjenës, pasi një gjë e tillë do të rrezikonte rrugën detare që lidhte Triesten, portin kryesor austro-hungarez, me “*detin botëror*”<sup>59</sup>. Sipas një dokumenti, i cili i takon fundit të dhjetorit 1912, qeveria austro-hungareze do të kërkonte pavarësinë e plotë të Shqipërisë. Por, në qoftë se do të ishte e pamundur të arrihej pavarësia, atëherë qeveria e Vjenës do të kërkonte që Shqipëria të vihej nën “*suzerenitetin vetëm nominal*” të Portës. Sipas diplomatëve vjenetzë, suzereniteti nominal nuk do të përbënte pengesë në zhvillimin e “*brendshëm shtetëror*”<sup>60</sup> të Shqipërisë.

Mbështetja që patën shqiptarët nga Austro-Hungaria dhe Italia, në Konferencën e Londrës, ishin faktorë vendimtarë për të shpëtuar Shqipërinë nga një copëtim edhe më i madh<sup>61</sup>.

Mbështetjes së qeverisë austro-hungareze ndaj çështjes shqiptare, atdhetarë nga vende të ndryshme, i shprehën mirënjohje dhe falënderime qeverisë së Vjenës. Nga fundi i vitit 1912, kolonia shqiptare në Bukuresht mbajti një miting, nga i cili i dërgoi një telegram ministrit të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, kontit Berchtold. Në telegramin e nënshkruar nga kryetari i kolonisë, Dr. Temo, shpreheshin falënderimet më të sinqerta për perandorin Franc Jozefi I, ministrin e Jashtëm, Berchtold dhe qeverinë austro-hungareze, për ndihmën e tyre në përkrahje të kauzës shqiptare<sup>62</sup>. Shqiptarët që jetonin në Sarajevë, i dërgonin një lutje Berchtoldit, nëpërmjet të cilës kërkonin nga ai që të mos lejonte shpërbërjen e territoreve të vilajeteve të Kosovës dhe të Shkodrës nga Shqipëria<sup>63</sup>. Gjithashtu, edhe banorët e Leskovikut, i dërgonin një lutje ministrit të Jashtëm austro-hungarez, kontit Berchtold, nga i cili kërkonin që t’i mbronte prej shteteve ballkanike<sup>64</sup>.

<sup>59</sup> Po aty, A-III-95. Chlumecky, L. von. *Interesimi i Austro-Hungarisë dhe Gjermanisë për një Shqipëri të fortë*. (Vepër në dorëshkrim, e cila ndodhet pranë Arkivit të Institutit të Historisë në Tiranë).

<sup>60</sup> Po aty, Vj. 22-11-1174. Rezervat, Referat I. Fundi i dhjetorit 1912.

<sup>61</sup> Murzaku, Thoma, *Politika Ballkanike...*, f. 184.

<sup>62</sup> AIH, Vj. 22-4-428. Telegram i kolonisë shqiptare në Rumani për ministrin e Jashtëm, Berchtold. Bukuresht, 1912.

<sup>63</sup> Po aty, Vj. 22-4-433. Lutje e shqiptarëve të mbledhur në Sarajevë, më 25 dhjetor 1912, për ministrin e Jashtëm austro-hungarez. Sarajevë, 1912.

<sup>64</sup> Po aty, Vj. 22-4-419. Raporti nr. 94, i konsullit Bilinski për ministrin e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, të cilit i kishte bashkëngjitur një Lutje të banorëve të Leskovikut drejtuar kontit Berchtold. Janinë, më 12 dhjetor 1912.

Studiuesi Stavro Skendi, me të drejt konstaton se një arsye e përgjithshme që i “*ktheu shqiptarët drejt*” Austro-Hungarisë, ishte nevoja për të ecur në një hap me kombet tjerë të Ballkanit. Në krahasim me armiqtë që i rrethonin, shqiptarët e ndjenin veten të vetmuar dhe se nuk mund ta fitonin pavarësinë kombëtare pa një mbështetje të jashtme. Shumica dërmuese e atdhetarëve shqiptarë, shpresonin se mbështetja e jashtme do të vinte para së gjithash nga Perandoria Dualiste, “*tek e cila ata shikonin interesa të njëjta*”. Në tërësi shqiptarët, sipas studiuesit në fjalë, ishin pro politikës së Austro-Hungarisë, të cilën ata e konsideronin si stimul më të madh për zhvillimin e ndërgjegjes së tyre kombëtare dhe një mbrojtëse të mirë të interesave të tyre<sup>65</sup>. Nga ana tjetër, Austro-Hungaria angazhohej për një Shqipëri sa më të madhe, e cila do të shërbente si një “*pykë e futur në mes të mes të sllavëve të Jugut*”<sup>66</sup>.

Disa vite pas krijimit të shtetit të pavarur shqiptar, njëri nga intelektualët e shquar të kohës, Eqrem bej Vlora do të shkruante se po të mos kishte qenë dora shpëtimtare e Monarkisë Austro-Hungareze me të cilën u detyrua të bashkohej edhe qeveria italiane “*përpyjekja e parë për të krijuar një Shqipëri të mëvetësishme, do të kishte qenë sot një ëndërr tashmë e harruar*”<sup>67</sup>. Vetëm Monarkia Austro-Hungareze u ndihmoi shqiptarëve, vetëm ajo i mbrojti ata nga “*budallallëku i turqve dhe nga lakmia e fqinjëve*” ballkanikë<sup>68</sup>. Falë Perandorisë Austro-Hungareze dhe forcës së atdhedashurisë së shqiptarëve, vendi i rezistoi të gjitha përpjekjeve që u bënë për ta shuar këtë entitet shqiptar: bastioni i fundit i pellazgëve antik<sup>69</sup>.

## Përfundimi

Që nga gjysma e dytë e shek. XIX, qeveria austro-hungareze filloi të interesohet për çështjen shqiptare. Dëbimi i Austro-Hungarisë nga bota gjermane, e detyroi atë të kërkonte zona të tjera ku ajo ta shtrinte ndikimin e saj si Fuqi e Madhe. E vetmja hapësirë e mundshme për realizimin e këtij qëllimi ishin tokat shqiptare. Shqiptarët si popull josllav, mund të ishin aleat i besueshëm i Vjenës. Nga ana tjetër dhe vetë shqiptarët kishin nevojë të siguronin mbështetjen e ndonjëres Fuqi

<sup>65</sup> Skendi, Stavro, *Zgjimi...*, f. 253, 258.

<sup>66</sup> Skendi, Stavro, *Mendimi...*, f. 31.

<sup>67</sup> Vlora, Eqrem bej, *vep. e përm.*, f. 12.

<sup>68</sup> *Po aty*, f. 65.

<sup>69</sup> Aref, Mathieu. 2007. *Shqipëria (Historia dhe Gjuha) ose odiseja e pabesueshme e një populli parahelen*. Tiranë: Plejad, f. 125.

të Madhe, pasi territoret e tyre rrezikoheshin të pushtoheshin nga fqinjët, të cilët kishin përkrahjen e vazhdueshme të Peterburgut. Rusia luante rolin e tutorit për sllavët e Ballkanit, duke mbështetur kërkesat e tyre për pushtimin e tokave shqiptare. Rreziku sllav, ishte faktori vendimtar që ndikoi në afrimin e shqiptarëve me qeverinë e Vjenës.

Austro-Hungaria i shihte shqiptarët si të vetmen mundësi për t'u vënë fre pretendimeve ruse, që nëpërmjet shteteve ballkanike të siguronte dalje në Adriatik. Rreziku i shtrirjes së ndikimit rus në këtë pjesë të Ballkanit përbënte rrezik për interesat austro-hungareze. Në funksion të interesave të veta strategjike dhe ekonomike, në momentin kur këto interesa rrezikoheshin hapur, pas fillimit të Luftës së Parë Ballkanike, Vjena i mbështeti kërkesat e shqiptarëve për autonomi ose pavarësi.

Megjithëse muajt e fundit të vitit 1912, në kryeqytetin austro-hungarez është diskutuar vazhdimisht çështja shqiptare dhe është potencuar fakti se ishte në interes të vendit të tyre krijimi i një Shqipërie me kufij sa më të gjerë, ata e kuptonin se fitorja e shteteve ballkanike në luftën kundër Perandorisë Osmane dhe pushtimi i gjerë i territoreve shqiptare nga ushtritë e këtyre vendeve nënkuptonte edhe nevojën e kompensimit territorial. Vet Berchtold në disa raste është shprehur se qeveria e tij nuk do të kundërshtonte pushtimin e disa territoreve shqiptare nga Serbia, por ai nuk do të lejonte pushtimin e pjesës perëndimore të këtyre territoreve, të cilat bënin pjesë në zonën austro-hungareze të interesit. Për Austro-Hungarinë ishte e pranueshme që Serbia të merrte Shkupin, sanxhakun e Novi Pazarit apo Kosovën, por me asnjë çmim nuk do të lejonte që këta të vendosnin kontrollonin e tyre brigjet lindore të Adriatikut.

Asnjëri nga popujt e Ballkanit nuk arriti të siguronte çlirimin kombëtar, pa mbështetjen e të paktën njëres nga Fuqitë e Mëdha. Prandaj, mbështetja e Austro-Hungarisë ishte e një rëndësie të veçantë edhe në arritjen e pavarësisë. Atdhetarët shqiptarë, me në krye Ismail Qemalin, vetëm pasi morën garancitë e nevojshme nga Vjena, Shpallën Pavarësinë e Shqipërisë. Gjithashtu edhe shtrirja territoriale e shtetit të ri shqiptar, që u njohë nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër qe rezultat, në radhë të parë i angazhimit të diplomacisë së Ballhausplatzit.

Që nga shek. XIX, Vjena ishte dhe mbeti, edhe pas shpalljes së pavarësisë kombëtare, aleati më i besueshëm dhe më i rëndësishëm i popullit shqiptar. Pa ndihmën e Austro-Hungarisë, shqiptarët do të kishin pësuar humbje edhe më të mëdha, nga ato të viteve 1912-1913.

## Burimet e shfrytëzuara:

### I. Dokumente arkivore:

1. Arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë, Fondi: Dokumente të sjella nga Arkivi Shtetëror në Vjenë dhe të përkthyer në gjuhë gjuhën shqipe;
2. Arkivi Qendror Shtetëror.

### II. Dokumente të botuara:

1. *Dokumenta Historike për t'i shërbye historiës kombëtare*, botues Lef Nosi, viti i I<sup>rë</sup>, Shtypshkronja “Elbasani”- Elbasan, mars 1924, Nr. 1;
2. Hoxha ,Teuta. 2002. *Ismail Qemali, Përmbledhje dokumentesh (1888-1919)*. Tiranë: Mësonjëtorja e Parë;
3. Nika, Nevila. 2003. *Përmbledhje dokumentesh mbi kryengritjet shqiptare (1910-1912)*. Prishtinë: Instituti i Historisë;
4. Verli, Marenglen & Dushku, Ledia. 2012. *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912), Vëllimi VI*. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike;

### III. Literatura:

1. Abdyli, Ramiz. 2004. *Lëvizja kombëtare shqiptare 1911-1912*, Libri 2. Prishtinë: Instituti i Historisë;
2. Aref, Mathieu. 2007. *Shqipëria (Historia dhe Gjuha) ose odiseja e pabesueshme e një populli parahelen*. Tiranë: Plejad;
3. Arsh, G. Ll. & I. G. Senkeviç & N. D. Smirnova. 1967. *Histori e shkurtë e Shqipërisë*. Prishtinë: Rilindja;
4. Durham, Edith. 2001. *Njëzet vjet ngatërresa ballkanike*. Tiranë;
5. *Енциклопедија на Југославија, издание на Македонски јазик*. 1983. Загреб: Jugoslovenski Leksikografski Zavod;
6. Frashëri, Mid'hat. 1999. *Fati i Shqipërisë*. Tiranë: Lumo Skëndo;
7. Freundlich, Leo. 1995. *Golgota shqiptare- Akuza kundër shfarosësve të popullit shqiptar*. Tiranë: Lilo;
8. Gurakuqi, Romeo. 2004. *Historia e Kohës së Re (2) Qytetërimi Perëndimor 1775-1871*. Shkodër: PHOENIXSHKODRA;

9. Gjermani, Sokol. 2008. Qëndrimi i Austro-Hungarisë ndaj Kryengritjes së vitit 1912. Në *Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek. XX*, (Përmbledhje studimesh). Tiranë;
10. *Historia e popullit shqiptar, vëllimi II, vitet 30 të shek. XIX-1912*. 2002. Tiranë: Toena;
11. Јелић, Милосав. 1931. *Албанија- Записи о људима и догађајима*, Београд;
12. Kadri, H. K. 1331 (sipas kalendarit musliman), 1912. *Türkiye'nin çöküşü*. İstanbul;
13. Krasniqi, Rexhep. 2007. *Kongresi i Berlinit e Verilindja e Shqipërisë*. Tiranë: Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Arbnori";
14. Malcolm, Noel. 2001. *Kosova- një histori e shkurtër*. Prishtinë: KOHA, Tiranë: Shtëpia e Librit;
15. Mehmeti, Drita. 1987. Politika e Fuqive të Mëdha imperia- liste ndaj kryengritjeve çlirimtare shqiptare të viteve 1910-1912. Në *Studime Historike*, Nr. 3. Tiranë;
16. Métais, Serge. 2006. *Histori e shqiptarëve- nga ilirët deri te Pavarësia e Kosovës*. Tiranë;
17. Mousset, Albert. 2004. *Shqipëria përballë Europës (1912-1929)*. Tiranë: Dituria;
18. Murzaku, Thoma. 1987. *Politika e Serbisë kundrejt Shqipërisë gjatë Luftës Ballkanike 1912-1913*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë-Instituti i Historisë;
19. Murzaku, Thoma & Sala, Kozeta. 2008. Politika e Austro-Hungarisë gjatë vitit të parë të Pavarësisë së Shqipërisë. Në *Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek. XX*, (Përmbledhje studimesh). Tiranë;
20. Nathanaili, Petrit. 2006. *Marrëdhëniet Ndërkombëtare nga origjina deri më sot, vëllimi i parë*. Tiranë: ShBLU;
21. Poincaré, Raymond. 2006. *Lufta e parë dhe e dytë Ballkanike si dhe konferenca e Londrës (1912-1913)*. Shkup-Prishtinë-Tiranë: Logos-A;
22. Prela, Zef. 1962. Problemi shqiptar dhe politika austro-hungareze (1897-1912). Në *Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, (Përmbledhje studimesh kushtuar 50 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë). Tiranë;
23. Prifti, Kristaq. 2008. Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe çështja e një shteti të njësuar kombëtar. Në *Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek. XX*, (Përmbledhje studimesh), Tiranë;

24. Puto, Arben. 1978. *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914*. Tiranë: 8 Nëntori;
25. Puto, Arben. 1984. *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, vëllimi I, (1867-1912)*. Tiranë: 8 Nëntori;
26. Ramadani, Fehari. 2010. Vështrim i shkurtër i krijimit dhe zhvillimit të Perandorisë Austro-Hungareze. Në *Kërkime Historike*, Nr. 4. Shkup: SHHSHM;
27. Rappaport, Alfred. 1928. *Rrjedhja e punëve në Shqipëri*, (përkthyer prej Karl Gurakuqit). Tiranë: Mbrothësia;
28. Reuter, Jens. 2003. *Shqiptarët në Jugosllavi*. Tiranë: Botimpex;
29. Rich, Norman. 2006. *Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1814-1914*. Tiranë: Toena, f. 205.
30. Schevill, Ferdinand. 2002. *Ballkani- Historia dhe qytetërimi*. Tiranë: Uegen;
31. Skendi, Stavro. 1958. *Mendimi politik dhe veprimtaria kryengritëse shqiptare 1881-1912-* (Përkthyer prej Sejfi Protopapës). New York;
32. Skendi, Stavro. 2000. *Zgjimi Kombëtar Shqiptar 1878-1912*. Tiranë: PHOENIX & Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit;
33. Smirnova, Nina. 2004. *Histori e Shqipërisë- përgjatë shekullit XX*. Tiranë: Ideart;
34. Swire, Joseph. 2005. *Shqipëria- ngritja e një mbretërie*. Tiranë: Dituria;
35. Тејлор, Ален Џ. П. 2001. *Хабсбуршка Монархија 1809-1918. Историја Аустриске Царевине и Аустроунгарске*. Београд: Clio;
36. *Udhëtime nëpër Ballkan- Kujtime nga jeta dhe vepra e Franc Baron Nopça*. 2007. Tiranë: Plejadë;
37. Vickers, Miranda. 2004. *Midis serbëve dhe shqiptarëve- një histori e Kosovës*. Tiranë: TOENA;
38. Vlora, Eqrem bej. 2003. *Kujtime 1885-1925*. Tiranë: Shtëpia e Librit & Komunikimit;
39. Vllamasi, Sejfi. 2000. *Ballafaqimet politike në Shqipëri (1897-1942)*. Tiranë: Neraida;
40. Zavalani, Tajar. 1998. *Histori e Shqipërisë*. Tiranë: PHOENIX & Shtëpia e Librit.